

Ruli: Misioni i Autoritetit te Konkurrences, thelbesor per ekzistencen e nje ekonomie funksionale tregu

Me lejoni t`ju falenderoj per ftesen qe me bete per te marre pjese ne kete eveniment qe shenon 5-vjecarin e ngritjes dhe funksionimit te Autoritetit te Konkurrences. Ne konceptim tim, misioni i institucionit tuaj eshte thelbesor per ekzistencen e nje ekonomie funksionale tregu. Ky kriter eshte nje nder kriteret baze te Kopenhagenit, dhe si i tille percaktues ne integrimin Evropian dhe Atlantik te vendit. Ai mundeson funksionimin korrekt te tregut, rregullat transparente dhe te barabarta per te gjithë si dhe nje treg i cili nxit inovacionin dhe korrigjon aktoret e tij. Ne jetojme ne nje periudhe te globalizimit te shpejte dhe te gjithanshem. Shqiperia po implementon nje politike te guxishme tregtare, te hapjes dhe liberalizimit gradual, duke plotesuar ne menyre te kenaqshme te gjitha detyrimet e drejtperdrejta e te terthorta qe rrjedhin nga Marreveshja e Stabilizim-Asociimit. Te gjitha keto hapa kane rritur ndjeshem presionin konkurrues mbi biznesin vendas. Kete e verejme jo thjesht ne kuadrin rajonal, por edhe ne ate evropian e me gjere. Pikerisht ne kete hapsire ku lojtare e aktore kryejne transakcionet e perditshme, tregu dhe konsumatorët kane nje rendesi te vecante. Ne teorine e sotme ekonomike pranohet gjeresisht se politikat liberale tregtare i kane sjelle biznesit vendas perfitime te konsiderueshme – si dhe nje doze te mire inovacioni, sidomos kur behet fjale per tregje te vogla si Shqiperia. Nderkaq, ne menyre qe konsumatori te marre optimumin e sherbimit dhe te cilesise se produktit, na duhet te sigurohemi se tregu funksionon, se ai promovon me te mirin dhe se eshte i orientuar drejt konsumatorit. Ne kete kendveshtrim, politikat e konkurrences ndahen ndermjet Reformes Regullatore te ndermarre nga Qeveria Shqiptare, Autoritetit te Konkurrences dhe Ndhimes Shteterore. Te treja keto koncepte ngaterrohen jo pak ne veshet e nje qytetari te zakonshem. Megjithate, si Ministri pergjegjes per dy prej tyre, dua te theksoj faktin se Qeveria Shqiptare ka bere hapa te medhenj perpara persa i perket derregullimit dhe lehtesimit te hyrjes se operatoreve ekonomike ne treg, por edhe persa i perket implementimit konsequent te Ndhimes Shteterore. Keto nderhyrje kane sjelle hapjen e tregut si dhe gjallerimin e konkurrences, por dhe nje perdorimin me eficient te parave te taksapaguesve—koncept ky i lidhur ngushte me Ndhimen Shteterore. Nga ana tjeter, Autoriteti i sotem i Konkurrences po jep prova se nepermjet mekanizmave qe ai ka ne dispozicion, po ndikon gjithnje e me shume ne eficencen ekonomike te tregjeve te produkteve dhe sherbimeve, ne dobi te konsumatorit shqiptar. Kjo eshte vecanerisht e vertete ndersa flasim per tregjet strukturalisht te perqendruara, si ai i telekomunikacionit, i energjise, etj.. Une dua te

pergezjoj dhe te inkurajoj vecanerisht nderhyrjet tuaja ne tregun e telefonise fikse dhe mobile, ne tregun e sigurimeve, te prodhuesve te bukes apo te prodhuesve te betonit. Tregu shqiptar eshte nje treg relativisht i vogel, dhe pergendrimet e aktiviteteteve tregtare ne duar te pak lojtareve ndodhim mjaft me lehte se ne tregjet e medha. Por pikerisht keto kane nje ndikim te madh ne konsumatorin final, apo ndryshe qytataret e ketij vendi, te cilet ashtu si dhe qytetaret evropiane kane te drejte te perftojne produkte te nje tregu te ndershem dhe konkurrent. Do te desha te ndalesha pak edhe ne temen qe ju keni zgjedhur sot per te trajtuar : « E drejta dhe politika e konkurrences ne tregjet e vogla dhe informale ». Shqiperia eshte sot nje treg gjithnje e me pak i vogel dhe gjithnje e me pak informal! Marreveshja CEFTA e cila ka hyre tashme ne fazen e saj te implementimit eshte pa diskutim arritja e te njejten kohe reforma jone me e madhe ne integrimin e ekonomise tone me ate rajonale. Implementimi i kesaj marreveshjeje do te sjelle « humbjen » e konceptit te ekonomise se vogel, aq me teper sot kur qeveria shqiptare i dedikon 10% te Prodhimit te Brendeshem Bruto te saj investimeve ne infrastrukture, te cilat do te sjellin ndikim te pashmangshem ne madhesine e tregut e te ekonomise. Shqiperia ne te njejten kohe eshte gjithnje e me pak informale: reformat e ketij 3 vjecari kane qene drastike, te miremenduar dhe efektplote. Rezultati eshte i dukshem dhe shenon hyrjen e konsiderueshme te ekonomise ne formalitet. Por ketu nuk ka vend per vetekenaqesi : baza e ekonomise shqiptare jane SME, Ndemarrjet e Vogla e te Mesme, per te cilat ne po zbatojme projekte konkrete mbeshtetese. Ne po implementojme hap pas hapi Karten Evropiane te SME, me nje fokus te vecante ne objektivat paresore te Procesit apo Axhendes se Lisbones: mbeshtetja per inovacion dhe konkurrueshmeri. Ne jemi te bindur se duke nxitur konkurrueshmerine, do te arrijme rritje te qendrueshme ekonomike si dhe krijim te vendeve te reja punes. Sidoqofte, efektet e reformave te qeverise do te jene pak te dukshme ne se ato nuk do te shoqerohen me zbatimin e instrumentave efikase qe ka sot ne dispozicion Autoriteti Konkurrences. Ketu une shikoj nje piketakimi te pashmangshem, te tille qe do te lere nje gjurme ne mjedisin ekonomik dhe tipologjine e tregut shqiptar. Ne se nuk do te veprojmë ne kordinim te plote mes nesh, Qeveria nga njera ane me reformat e saj te avancuara derregullatore si dhe Autoriteti Konkurrences nga ana tjeter me instrumentat qe disponon, ndoshta nuk do te kemi SME kompetitive dhe konsumatore te kenaqur me prodhuktet apo sherbimet qe ofrohen. Sigurisht qe ndersa shpreh keto konsiderata e kam shume te qarte qe «kultura e konkurrueshmerise» eshte nje proces i gjate, i veshtire dhe jo nje aksion i castit. Ky proces kerkon ndryshimin e mentalitetit, kerkon vendosmeri nga ana juaj, por

edhe mbeshtetje nga Qeveria, mbeshtetje e cila nuk ka munguar keto vite te fundit. Prandaj sot, duke e mbyllur fjalen time ju pergezoi per arritjet dhe ju nxis te mbani ritmin e kenaqshem ne arritjen e objektivave tuaj te metejshme!